



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. ____ prot.

Tiranë ____/03/2025

Lënda: Mbi ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj, për të na vënë në dispozicion një ambient me qëllim organizimin e aktivitetit “Ditë të Hapur”, në Bashkinë Gjirokastrë

Drejtuar: Bashkisë Gjirokastrë

Adresa: Sheshi “Çerçiz Topulli”, 6001

GJIROKASTËR

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të detyrës funksionale, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, do të zhvillojë një “Ditë të Hapur”, në **Bashkinë Gjirokastrë**, me qëllim informimin e shtetasve mbi rolin e institucionit tonë, si dhe për pritjen e shtetasve apo Organizatave Jofitimprurëse në qytetin tuaj, në lidhje me problematika të ndryshme që ata mund të kenë.

Nga ana jonë është planifikuar që ky aktivitet, të zhvillohet në datën **07.04.2025**, nga ora **11:30-14:00**.

Në emër të Avokatit të Popullit zj. Erinda Ballanca, do të kërkonim ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj, për të na vënë në dispozicion një ambient të përshtatshëm në Bashkinë Gjirokastrë, për të bërë të mundur takimin e mësipërm.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të përfaqësohet në këtë takim nga Ndhmëskomisionerët e Seksionit për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, z. Alket Jaupi, z. Enio Haxhimihali dhe znj. Jonida Vila¹

Duke Ju falënderuar paraprakisht për mirëkuptimin, mbetemi në pritje të përgjigjes.

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI

¹ Për më tepër detaje mund të kontaktoni me e-mail jonida.vila@avokatipopullit.gov.al